

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, në përbërje të trupit gjykues prej gjyqtarës Raima Elezi, si kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarëve Alia Fazlji dhe Nazim Vllaqo, si anëtarë, me sekretaren juridike Valdete Zurnaxhiu, në lëndën penale kundër të akuzuarve B. L. dhe F. L., të dytë nga fshati D. Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale lëndimi i rënd trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par. 2 pika 2.1 e lidhur me nenin 31 të KP-së, F. L. edhe për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.1 të KP-se, H. L., F. L. dhe V. L., të gjithë nga fshati D. Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 pik. 1.1 lidhur me nenin 31 të KP-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.615-3/2-16-II të datës 14.08.2017 dhe pjesërisht të ndryshuar në fjalën përfundimtare me datën 12.06.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren Ervehe Gashi, të akuzuarve B. L., mbrojtësi i tij av. A. J., F. L., mbrojtësi i tij av. O. R., H. L., F. L., V. L. dhe mbrojtësi i tij av. I. Xh. K., me datë 18.06.2018, publikisht mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

**B. L.**, nga i ati A. dhe ëma S., e lindur K., i lindur me datë *data e lindjes...*, në fshatin D. Komuna e Suharekës , ku edhe tani jeton ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar babai i tre fëmijëve, bujk ,shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr. personal *numri personal...*

**F. L.**, nga i ati A. dhe ëma S., e lindur K., i lindur me datë *data e lindjes...*, në fshatin D. Komuna e Suharekës , ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar babai i dy fëmijëve, bujk ,shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr. personal *numri personal...*

**H. L.**, nga i ati H. dhe e ëma H., e lindur K., i lindur me datë *data e lindjes..* në fshatin D. Komuna e Suharekës, ku edhe tani jeton, i martuar – baba i katër

fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, pensionist, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal *numri personal*....

**F. L.**, nga i ati H. dhe e ëma M., e lindur Z. i lindur me datë *data e lindjes*... në fshatin D. Komuna e Suharekë, ku edhe tani jeton, i martuar, babi i një fëmije, ka të kryer fakultetin Filozofik – Departamenti i historis, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal *numri personal*....

**V. L.**, nga i ati H. dhe e ëma M., e lindur Z., i lindur me datë *data e lindjes*... në fshatin D. Komuna e Suharekë, ku edhe tani jeton, beqar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, punëtor shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal *numri personal*...

## **JANË FAJTORË**

### **Të akuzuarit B. L. dhe F. L.**

I.Me datën 13.02.2016 rreth orës 11:00, në fshatin D., Komuna e Suharekës, te vendi i quajtur ....., në cilësi të bashkëkryerësve, i shkaktojnë lëndime trupore dhe me këtë rast e rrezikojnë jetën e të pandehurit V. L., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshjeje, e lidhur me prerjen e druve në pyll në mes të pandehurve H., F. dhe V. L., në një anë dhe B. e F. L. në anën tjetër, i pandehuri B. L., e godet të pandehurin V. L. me një moto sharrë – mjet ky i rrezikshëm dhe i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor dhe shkakton lëndime: një plagë prerës me gjatës 15cm, në anën e djathtë të sipërme të kokës, disa plagë prerës në anën e djathtë të fytyrës, të cilat janë paralele secila me gjatësi rreth 3cm dhe plagë në pjesën e jashtëm të pjesës së poshtëm të parakrahut të dorës së majtë, ndërsa i pandehuri F. L. të njëjtin e ka goditur i shkakton një plagë shquese ndrydhëse në pjesën e jashtëm të regjionit të bërrylit të dorës së majtë, me dimensione rreth 10 x 2 cm , lëndim këto të konstatuara nga dr. M. G., të dhënë me datë 05. korrik 2016 dhe me datën 23.02.2018, të cilat plagë janë karakterit të lëndimeve të rënda trupore.

**-me këtë si bashkëkryerës kanë kryer veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par. 2 pik 2.1 lidhur me nenin 31 të KP-së**

## **I akuzuari F. L.**

**II.** Se me datë 13.02.2016 rreth orës 11:00, në fshatin D. Komuna e Suharekës, te vendi i quajtur ..... i shkakton lëndime trupore dhe përkohësisht ia dëmton shëndetin e të pandehurve H. L. dhe F. L., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje e lidhur me prerjen e druve në pyll, në mesë të pandehurve H., F. dhe V. L., në një anë dhe B. e F. L. në anën tjetër, i pandehuri F. L. e godet në kokë dhe në hundë me qykë e sakicës – mjetë ky i rrezikshëm dhe i përshtatshëm për shkaktim e lëndimit të rëndë trupor, me ç raste i shkakton mavijosje në kokë dhe hundë së bashku me gërvishtje në regjionin e hundës dhe të ballit, të kualifikuar me lëndime të lehtë trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin, lëndime të konstatuara nga dr. M. G., të dhënë me datën 05. korri. 2016 poashtu edhe të pandehurit F. L. me mjetin e njejtë e godet në anën e majtë të shpinës, me ç raste i shkakton ndrydhje në anën e majtë të shpinës, të kualifikuara me lëndime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin, lëndime të konstatuara nga dr. M. G. të dhënë me datën 05.korrik 2016.

**-Me këtë ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupore nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 pika 1.1 të KP-së.**

## **Të akuzuarit H., F. dhe V. L.**

**III.** me 13.02.2016 rreth orës 11:00, në fshatin D. Komuna e Suharekës, te vendi i quajtur .... si bashkëkryerës i shkaktojnë lëndime trupore dhe përkohësisht ia dëmtojnë shëndetin e të pandehurve B. dhe F. L., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje lidhur me prerjen e druve në pyll, në mesë të pandehurve H., F. dhe V. L., në një anë dhe B. e F. L. në anën tjetër, të pandehurit H., F. dhe V. L. e godasin me dru në gjatësi rreth 1 metër të pandehurit B. në regjionin e fytyrës, regjionin e shpatullës së djathtë dhe në regjionin e shpinës, mjet ky i rrezikshëm dhe i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor, ndërsa të pandehurin F. L. me po ato mjete e godasin në kokë, fytyrë dhe në qafë, me ç raste të pandehurit B. L. i shkaktojnë lëndime trupore në formë të gërvishtjes në regjionin e fytyrës, ndrydhje në regjionin e shpatullës së djathtë dhe në regjionin e shpinës, të pandehurit F. L. i shkaktojnë lëndime në formë të ndrydhjeve në kokë dhe në qafë, plagë shqyese e ndrydhëse në kokë dhe gërvishtje në regjionin e fytyrës, të kualifikuar me lëndime të lehtë trupore me pasoj të përkohshme për shëndetin, lëndime këto të konstatuara nga dr. M. G., të dhënë me datën 05. korr 2016.

**-Me këtë kanë kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 pik. 1.1 lidhur me nenin 31 të KP-së**

Andaj, gjykata në bazë të neneve 7, 8, 9, 10, 21, 41, 42, 45, 51, 69, 73, 74, 76 dhe 80, të KP-së dhe neneve të përmendura më lartë e

## **G J Y K O N**

- Të akuzuarin **B. L.**, për veprën penale nën **I/** të dispozitivit, me dënim me burg në kohë zgjatje prej 6 (gjashtë) muaj;

- Të akuzuarin **F. L.**, për veprën penale nën **I/** të dispozitivit, me dënim me burg në kohë zgjatje prej 5 (pesë) muaj, për veprën penale nën **II/** të dispozitivit me dënim me burg në kohë zgjatje prej 1 (një) muaj ashtu që gjykata e gjykon me dënim unik me burg në kohë zgjatje prej 5 (pesë) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë;

-Ndaj të akuzuarve **H. L.**, **F. L.** dhe **V. L.**, për veprën penale nën **III/** të dispozitivit shqiptohet

## **G J Y K I M I M E K U S H T**

ashtu që të akuzuarit **H. L.**, i vërteton dënimin me burg në kohë zgjatje prej 6 (gjatë) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale;

-të akuzuarit **F. L.**, i vërteton dënimin me burg në kohë zgjatje prej 6 (gjatë) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale;

-të akuzuarit **V. L.** i vërteton dënimin me burg në kohë zgjatje prej 6 (gjatë) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale;

Prej të akuzuarit **B. L.** konfiskohet motor shara e tipit **SHTIL**, me ngjyrë të kuqe dhe prej të akuzuarit **F. L.** një sopat, si mjete për kryerjen e veprave penale.

Të akuzuarit në cilësinë e dëmtuarit edhe atë **B. L.**, **F. L.1**, **H. L.**, **F. L.2** dhe **V. L.** udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

Obligohen të akuzuarit B. L., F. L.1, H. L., F. L.2 dhe V. L. që solidarisht të paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës sipas llogaris së gjykatës, në emër të ekspertizës mjeko ligjor ndërsa në emër të paushallit gjyqësor secili shumën prej nga 100 € dhe secili nga 50 € në emër të kompensimit për viktimat e krimit, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.615-3/2016-II të datës 14.08.2017, kundër të akuzuarve B. L. dhe F. L.1, nga fshati D. Komuna e Suharekës, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 pik. 1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-së, F. L.1 , edhe për dy vepra penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par. 1 pika 1.1 të KP-së, H., F.2 dhe V. L., të gjithë nga fshati D. Komuna e Suharekës, për shkak të veprës lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 e lidhur me par 1 pik. 1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-së.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka theksuar se në bazë të provave të administruara është vërtetuar se të gjithë të pandehurit kanë pohuar se ka ndodhur një përleshje në mesë tyre, kanë përshkruar mjetet me të cilat janë goditur dhe kanë treguar pjesët e trupit në të cilat janë lënduar dhe të cilat janë përshkruar në ekspertizën e ekspertit mjeko ligjor dhe në deklaratën e ekspertit të dhënë në shqyrtimin kryesor. Eksperti mjekësor sa i përket të akuzuarve B. dhe F. L.1 ka konstatuar se kanë shkaktuar lëndime të rëndë trupore, të rrezikshme për shkak të gjakderdhjes së madhe të akuzuarit – dëmtuarit V. L., lëndimet të cilat kanë qenë rrezikshme për jetën ashtu që në bazë të konstatimit prokuroria ka ardhur në një rrethanë të re në bazë të cilës ndryshon kualifikimin e veprës penale ashtu që të akuzuarit B. dhe F. L.1 e akuzon për veprën të njejtë penale por nga par. 5 lidhur me par. 2 pik. 2.1 e lidhur me nenin 31 të KP-së. Sa i përket të akuzuarit F. L.1 i cili sipas aktakuzës akuzohet edhe për dy vepra penale lëndimi i lehtë trupor, konsideron se pas analizimit të çështjes penale ka ardhur në përfundim se të gjitha veprimet në drejtim të këtij të akuzuar, në drejtim të të dëmtuarve i ka marr në intervalin e njejtë kohorë, në vendin e njejtë ashtu që duke u bazuar në praktikën gjyqësor të Gjykatës Supreme të Kosovës konstaton se kemi të bëjmë me një vepër penale e jo me dy vepra penale. Prokuroria ka analizuar edhe varianten e veprës penale në vazhdimësi mirëpo konsideron se veprimet e të akuzuarit nuk përkojnë me veprën penale në vazhdim nga se nuk janë drejtuar ndaj personit të njejtë. Sa i përket të akuzuarve H., F.2 dhe V. L. mbetet në tërësi pranë fjalës

përfundimtare me shkrim se në veprimet e tyre formohen elementet esenciale të veprës penale lëndimi i lehtë trupor, në bashkëkryerje, nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 pik. 1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-së . Propozon që të akuzuarit të shpallen fajtor për veprat penale për të cilat akuzohen dhe të dënohen sipas ligjit. Si rrethana rënduese i propozon për të gjithë të akuzuarit gjykata të merr parasysht faktin se në mesë vete janë familjar, motivin e kryerjes së veprës penale e në drejtim të të akuzuarit F. L.1 edhe faktin se këtë veprën penale e ka kryer në drejtim të të dy të dëmtuarve ndërsa si rrethanë lehtësuese për të gjithë të akuzuarit propozon sjelljen korrekt para gjykatës dhe faktin se për herë të parë gjenden në konflikt me ligjin .

Mbrojtësi i të akuzuarit B. L. av. A. J. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga deklaratat të akuzuarve vërtetohet se të njëjtit janë kushërirë në mesë vete dhe se çështja pronësoresh juridike në mesë tyre nuk është zgjedhur ende. Nga certifikata mbi pronësi rrjedh se ngastrata katastrale 00386-0 , në vendin e quajtur ... me kulturë mal, në sipërfaqe prej 7769m<sup>2</sup> është në bashkëpronësi të H. L., G. P. dhe M. Q. dhe është larg shtëpive të të akuzuarve diku 4 – 5 km në vijë ajrore. Ditën kritike i akuzuari B. së bashku me vëllain e tij F. L.1 kanë shkuar në malin e përbashkët për të prerë dru dhe deri sa kanë qenë duke i bartë drutë kanë ardhur të akuzuarit H., F.2 dhe V. L. kinse për të vërtetuar kush po e dëmton malin e tyre dhe në atë raste ka ardhur deri te përleshja në mesë tyre. Gjykata nuk duhet të pranojë deklaratën e të akuzuarit H. L. deri sa ka qenë në oborrin e shtëpisë ka dëgjuar një moto sharë ka ftuar djemtë e tij dhe ka shkuar në mal. Kjo sepse largësia deri në mal si dhe frekuentimi nuk mundësojnë që të dëgjohet puna e moto sharës por e kanë përcjellë të akuzuarit B. dhe F. L.1 e pastaj kanë shkuar në vendin e ngjarjes. Është vërtetuar se të akuzuarit H., F.2 dhe V. kanë pasur nga një dru në dorë ku të gjithë kanë pësuar lëndime trupore. Konsideron se nga provat e administruara në asnjë mënyrë nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij me sharë motorike të ketë sulmuar të dëmtuarin V. L. pasi që moto shara ka qenë duke punuar në tokë e gjatë përleshjes është e mundur që i akuzuari V. është lënduar në te. Në anën tjetër duke ditur se vetëm prekja me motor sharë, në pjesën ku aludon i dëmtuari Veton në fytyrë ose në dorë me siguri do të ia këpute kokën dhe dorën. Nuk mundet të ekziston bashkëkryerja e veprës penale lëndim të rëndë trupore sepse nuk ka pasur kurrfarë marrëveshje paraprake ose eventualisht planifikimi në kryerjen e veprës penale duke pasur parasysht se i akuzuari H. me dy djem kanë ardhur pa kurrfarë paralajmërimi. Në bazë të mendimit të mjekut dr. M. G., të dhënë në seancën vërtetohet se lëndimet të shkaktuar secila veç e veç janë lëndimet të lehta trupore ndërsa si tërësi paraqesin lëndimet të rënda. Konsideron se në veprimet e të mbrojturit të tij eventualisht mund të formohen elementet e veprës penale lëndimet të lehtë trupor nga neni 188 të KP-së andaj propozon që gjykata të

njëjtin të shpallë fajtor dhe shqiptoj dënimin adekuat duke marr parasysh se është njeri familjar, relativisht i ri, deri tani i padënuar dhe se rastin e ka nxit i akuzuari H. me djemtë e tij, sjelljen korrekt para gjykatës di dhe faktin se edhe ai ka pësuar lëndime trupore.

I akuzuari B. L. në fjalën përfundimtare ka shtruar se pendohet për veprimet e veta, publikisht kërkon falje nga kushërinjtë dhe premtan se në të ardhmen nuk do të vijë në konflikt me ligjin, si i dëmtuar nuk parashtron kërkesën pasuroro juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit F. L.1 av. O. R. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se dispozitivi i aktakuzës me të cilën ngarkohet i mbrojturi i tij në dëme të dëmtuarit F. L.1 është tejet konfuz, e përgjithësuar dhe nuk ka përcaktuar veprimet konkrete inkriminuese se ku dhe në cilën pjesë të trupit dhe me çfarë mjetë ka goditur të dëmtuarin V. L. dhe nuk janë konkretizuar në mënyrë të ndarë se si së bashku me të akuzuarin B. paskan shkaktuar lëndime në trupin e të dëmtuarit V., me çfarë mjete kanë goditur, kush ka goditur i pari njeri tjetrit andaj nuk mund të pranohet një akuzë e tillë duke pas parasysh se ekzistojnë provat se paraprakisht të mbrojturin e tij kanë sulmuar të akuzuarit V., H. dhe F. L.2 të cilit me dashje dhe para përgatitje me dru në duar kanë sulmuar B. dhe F.1 andaj konsideron se në veprimet e të mbrojturit të tij ekzistojnë elementet e veprës penale në mbrojtjen e nevojshme sepse kanë qenë të detyruar që të dëbojnë sulmin e tyre të drejtë për drejtë. Po ashtu nuk qëndrojnë elementet e veprës penale lëndimet e lehtë trupor ndaj të akuzuarve – të dëmtuarve H. L. dhe F. L.2 pasi që ata paraprakisht kanë sulmuar të akuzuarin B. L. dhe të mbrojturin e tij F. L. me motivacion të pabazuara se kinse mali ku kanë prerë drutë B. dhe F. është mali i tyre edhe pse kjo pasuri e paluajtshme është pasuria e përbashkët trashiguar prej të parëve të tyre e cila deri sot nuk është ndarë dhe nuk është bërë bartja e pasurisë së cekur në emër të H. L.. Andaj shkaktari i rastit në përgjegjësi është në anën e të akuzuarve H. dhe djemtë e tij të cilit kanë ardhur në vendin e ngjarjes dhe kanë filluar të sulmojnë me shtaga të akuzuarit B. dhe F. L.1 . Andaj gjykata nuk duhet të pranon deklaratat e të akuzuarve H., V. dhe F. L.2 sepse ata kanë ardhur në vendin e ngjarjes për të ndaluar prerjen e druve në mal kinse është prona e tyre personale dhe kinse kanë ardhur pasi që kanë dëgjuar zërin e sharës motorike edhe pse kjo është e pamundur pasi që largësia është afër 7 km, konsideron se konfliktin kanë filluar të akuzuarit H., V. dhe F. L.2 dhe kanë shkaktuar lëndimet e lehta trupore të akuzuarve B. dhe F. L.1 të cilit edhe më herët kanë pasur disa mosmarrëveshje verbale dhe ngjarja është shndërruar në veprimet e kundërligjshme nga të dy anët dhe përgjegjësia më shumë qëndron në anën e të akuzuarit H. dhe djemtë e tij si iniciator i konfliktit. Nuk mund të pranohet kualifikimet e gabuara nga aktakuza se të akuzuarit B. dhe

F.1 kanë shkaktuar lëndime trupore të akuzuarve H., V. dhe F. L.2 me motor sharë dhe me sopat nga se këto mjete janë tepër të rrezikshme dhe mund të shkatërrojnë trupin e njeriut deri në vrasje ose të shkaktojnë lëndime fatale trupore ndërsa nga raporti i mjekut del se këto lëndime në trupin e të dëmtuarit V. nuk janë me pasoja të përhershme por vetëm të rrezikshme me rastin e shaktimit të lëndimeve të lehtë trupore. Të akuzuarit H., V. dhe F. L.2 në deklaratat e tyre nuk kanë dhënë në mënyrë konkrete se cili prej të akuzuarve B. apo F. kanë shkaktuar lëndime trupore dhe me cilën pjesë të sharës ose të sopatës, janë labil dhe jo të sinqertë andaj deklaratat e tyre nuk duhet të pranohen si të vërteta dhe gjykata duhet të analizon me kujdes për të formuan bindjen për veprimet të kundërligjshme për çdo njërin të akuzuar për të marrë vendimin e duhur për përgjegjësin e tyre penale. Në shqyrtimin kryesor ka shtuar se konsideron se në veprimet e të akuzuarve B. dhe F. L. nuk ekziston bashkëkryerja sepse nuk ka pas marrëveshje paraprake. Pasi që të akuzuarit janë të një gjaku, kushërinjtë të afër mendon se në mesë tyre është zhvilluar një konflikt pa dashje ku të dy anët janë lënduar, propozon që gjykata duhet të vlerësoi peshën e tyre të përgjegjësisë dhe në bazë të kësaj të jep dënime meritore. Si rrethanë lehtësues propozon që të vlerësohen se kanë qenë korrekt gjatë zhvillimit të procedurës, se kanë dërguar personat për pajtimin në mesë tyre dhe tani kërkojnë falje për rastin.

I akuzuari F. L.1 në fjalën përfundimtare ka deklaruar se kërkon falje për rastin e ndodhur, është i gatshëm dhe publikisht kërkon falje dhe si i dëmtuar nuk parashtron kërkesën pasurore juridike.

I akuzuari H. L. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se konsideron se ndaj tij është bërë shumë padrejtësi me ngritjen e aktakuzës me të cilën akuzohet për veprën penale lëndimet të lehta trupore sepse nuk ka sulmuar askënd, ka qenë i sulmuar dhe i lënduar. Është dëmtuar si në pronë ashtu edhe në shëndet dhe se nuk është e vërtet se ai me djemtë e tij ka nxitur situatën sepse kanë shkuar vetëm për të shikuar se kush janë personat në mal. Pas rastit dhe me kalimin e kohës emocionet dalëngadalë qetësohen por ende nuk është i gatshëm të pranojë kërkimin e faljes nga të akuzuarit B. dhe F. L.1, por do të mundohet që të punojnë në atë drejtim. Propozon që ndaj tij gjykata të merr aktgjykim lirues e sa i përket kërkesës pasurore juridike do të vendos më vonë.

I akuzuari F. L.2 në fjalën përfundimtare ka deklaruar se propozon që gjykata të hedh poshtë aktakuzën ndaj tij sepse është sulmuar në pronën e tij, i është cenuar jeta dhe prona private. Sa i përket rregullimit të raporteve në mesë tyre e përkrahe fjalën e babait ndërsa sa i përket kërkesës pasurore juridike do të vendos më vonë.



Mbrojtësi i të akuzuarit V. L. av. I. Xh. K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se aktakuza sa i përket të mbrojturit të tij nuk ka bazë ligjore dhe nuk mbështetet me asnjë provë dhe fakt me të cilin vërtetohet se i njëjti ka kryer veprën penale e cila i vihet në barë. Deklaratat i të akuzuarve janë në kundërshtim në mesë vete. I mbrojturi i tij në asnjë momente nuk ka provokuar sulmin apo situatën pasi që nga shumica e të akuzuarve kanë treguar se V., F.2 dhe H. kanë shkuar për të iu tërheq vërejtjen të akuzuarve B. dhe F. L.1 se janë duke dëmtuar pronën e huaj dhe se do të shihen në gjykatë në çoftë se do të ishte e kundërta do ta kishim mos përputhje me deklarinimin e të njëjtëve. Lëndimet e lehta trupore që kanë pësuar të akuzuarit B. dhe F. L.1 nuk janë shkaktuar nga veprimet e vullnetshme dhe me dashje nga veprimet e të mbrojturit të tij por në momentin e vërsuljes me sharë motorike nga ana e B. L. i mbrojturi i tij ka qenë i detyruar të vetë mbrohet në atë mënyrë që duke e larguar sharën nga koka dhe fytyra e ka shtyrë B. dhe duke u vetë mbrojtur nga F.1 i cili me sopat e ka sulmuar në kokë ashtu që gërvishtjet eventuale që kanë munduar të shkaktohen në trupin e F.1 dhe B. janë gërvishtje të marrura nga drunjte të cilat kanë qenë në tokë, ku terreni ka qenë i papërshtatshëm, për të cilat lëndime eksperti mjekoligjor ka pohuar se këto lëndime kanë mund të shkaktohen nga mjetet e forta, atë mprehta e që përputhen me mbetje drunjëve të prerura në tokë propozon që gjykata të merr aktgjykim lirues duke u mbështetur në nenin 12 par. 1 të KP-së ku është i paraparë se vepra penale e kryer me mbrojtje të nevojshme nuk është vepër penale.

I akuzuari V. L. në fjalën përfundimtare ka shtuar se ka vepruar në vetë mbrojtje, në pronën e tij e sa i përket raporteve në mesë tyre konsideron se me kalimin e kohës do të përmirësohen. Parashtron kërkesën pasurore juridike ndaj të akuzuarve F.1 dhe B. L..

I akuzuari B. L. në mbrojtjen e vet pranë prokurorisë ka deklaruar se F.1 e ka vëlla, H. djalë të mixhës ndërsa F.2 dhe V. janë djemtë e H.. Me këta ditën kritike kanë pasur një mosmarrëveshje meqenëse e kanë një mal të përbashkët i cili është në emër të babait të H. të cilën nuk e kanë ndarë fizikisht edhe pse i takon edhe babait të tyre i cili është i ndjerë. Ditën kritike së bashku me F.1 kanë shkuar në mal me pre dru dhe ne ndërkohë kanë ardhur H., F.2 dhe V., së pari F.2 iu është drejtuar me fjalë “ pse keni prerë dru në pronën tonë”, kanë thanë se prona është e përbashkët dhe ju para një kohe keni marr dru e ne nuk kemi bërë probleme. Ata kanë pasur në duar ka një copë dru të gjatë rreth 1 m dhe kanë filluar ti godasin prandaj edhe këta kthyer sulmin duke i goditur me dru duke u përlesh janë rrokullisur disa herë meqenëse vendi ka qenë tatëpjete ashtu që kanë pësuar lëndime trupore më shumë se që i kanë goditur njeri tjetrin. Në shqyrtimin

kryesor ka shtuar se shtëpia e tij dhe shtëpia e djalit të mixhës janë në një oborr dhe nuk kanë murrë në mesë, vendi ku kanë prerë dru është në një largësi prej 4 – 5 km vijë ajrore, diku 7 km rrugë. Raportet në mes tyre janë prishur para 2 – 3 vite edhe atë në vend ku kanë shitur pemë në rrugë. Na mal ka pas motor sharën, një sakicë dhe kanë shkuar me traktor. Në momentin kur ata kanë ardhur ka qenë duke prerë dru me motor sharën e kur janë afruar në distancë prej 2 metër së pari me dru i ka sulmuar V. në pjesën e ballit ashtu që motor shara i ka ra në tokë, dhe ka mbetur e ndezur deri sa janë kacafytur përmbi motor sharrë . F.1 në ato momenti ka qenë në një distancë 4 - 6 m dhe është kacafytur me H. dhe F.2, në fund edhe H. e ka sulmuar. Janë rrahur deri sa janë lodhur deri sa H. i ka thanë a po len, më boll se kena me mbytë ashtu që e kanë ndërprerë përlëshjen. I kujtohet se motor sharën e ka ndalur pas përfundimit të ngjarjes.

I akuzuari F. L.1 në mbrojtjen e vet ka deklaruar se ditën kritike me vëllain B. kanë shkuar në malin e përbashkët për të prerë dru. Në ndërkohë kanë ardhur djali i mixhës H. me dy djem F.2 dhe V. ku së pari F.2 i është drejtuar me fjalë “ pse keni prerë dru në pronën tonë, a të ka bo baba” , të tretë kanë pasur në duar ka një copë dru rreth 1m dhe kanë filluar ti godasin ashtu që edhe ata i kanë kthyer goditjet dhe duke u përlëshur janë rrokullisur disa herë meqenëse vendi ku ka ndodhur përlëshja ka qenë tatëpjete. Në shqyrtimin kryesor ka shtuar se H. e ka djalë axhe, më herët nuk kanë pasur raporte të mira, kanë pasur përllarje dhe mosmarrëveshje për shkak të pronës mirëpo nuk janë drejtuar gjykatës për zgjedhjen e konfliktit. Mali gjendet në vendin e quajtur ... dhe i takon babës së H., H. dhe babës së tij A.. Prej shtëpisë deri në mal distanca është 7 – 8 km, në atë largësi nuk mund të dëgjohet zhurma e motosharrës. I kujtohet se prej shtëpisë janë nisur diku në ora 10:30, kanë shkuar me traktor të tipit “Ferguson”, kanë pasur motosharrën dhe sakicën dhe në momentin deri sa ka prerë dru me sakicë, deris B. ka punuar me motosharrë në një distancë prej 4 – 5 metra ka vërejtur kur i pari ka ardhur F.2, ka bërë foto me telefon dhe ka thanë “ a ju ka bërë baba këtë mal që po preni”, pastaj ka ardhur H. me V., kanë pasur dru në duar, kanë qenë duke vrapuar dhe kur kanë qenë në largësi prej 4 – 5 metra i ka thanë “H. nali djemt” por ai nuk i ka ndalë dhe pa asnjë fjalë ka filluar rrahja ashtu që nuk mund të dinë se kush i pari i ka goditur dhe kush kë e ka goditur e as kujt i ka mëshuar ai me dru, në atë moment sakica ka qenë në tokë dhe deri sa janë rrahur motosharra ka qenë në tokë e ndezur dhe ka punuar në tokë derisa B. e ka ndalur pas përfundimit të përlëshjes. I kujtohet momenti kur H. dhe V. e kanë lënduar me dru, kjo ka ndodhur në fund të kacafytjes pasi që ka dëgjuar se në një momente H. ka thanë djemve “boll se u mbytem për kurrjë hiq“. Deri atë ditë nuk kanë pre dru në atë mal sepse kanë punuar në atë drejtim që të ndahet pasuria e përbashkët ndërsa H., V. dhe F. më herët kanë prerë dru. I kujtohet se e ka goditur H. me dru por në cilën pjesë të

trupit nuk e di por pasi është goditur nga H. me dru e pastaj ka filluar përleshja me F.2 dhe V..

I akuzuari H. L. në mbrojtjen e vet ka deklaruar se ditën kritike ka dëgjuar një zhurmë të motosharrës në mal, në pronën e tij ashtu që me dy djemtë F.2 dhe V. kanë shkuar aty dhe kanë parë B. dhe F.1 duke prerë dru. F.2 me telefon ka fotografuar dhe u kanë thanë shihemi në gjykatë. Menjëherë është afruar F.1 me sopat në dorë, i ka thanë “largohu çka jeni duke bërë”, F.1 është larguar 3 – 4 metra, B. ka pasur në dorë motor sharë e ndezur. Ka thanë F.2 dhe V. që të shkojnë në shtëpi mirëpo sapo ka kthyer shpinën i ka goditur F.1 me qyk të sëpatës, nga kjo goditje ka rënë në tokë ashtu që më pas nuk ka parë asgjë e kur i ka ardhur vetëdija e ka parë V. të gjakosur në kokë dhe në fytyrë, ndërsa Fatoni e ka marrë motosharrën nga dora e B. e pastaj kanë shkuar në shtëpinë e shëndetit në Suharekë. Nuk ka goditur askënd dhe nuk e din si kanë pësuar lëndime trupore ata. Në shqyrtimin kryesor ka shtuar se kur kanë arritur në vendin e ngjarjes B. nuk ka pasur në duar asgjë, motor shara ka qenë në tokë afër tij e ndalur ndërsa F.1 ka pas sakicën në dorë, prej largësisë afër 20 m ka parë se B. dhe F.1 kanë qenë duke ngarkuar drutë e prera në traktor e kur janë afruar F.1 ka krasitur drutë me sopat. B. ka marr motosharrën, e ka ndezur dhe ka sharë me nënë duke i thanë “ju kallëzoj unë” dhe motosharrën ka drejtuar në Vetonin i cili ka qenë afër, ndërsa F.2 me sakicë është afruar tek ai dhe ka goditur në shpinë në kurrize e kur e ka kthyer kokën përsëri ka goditur në kokë me qyken e sëpatës ashtu që ka ra në tokë. Kur i ka ardhur vetëdija dhe është ngrit ka parë V. dhe F.1 që janë rrëzuar mbi drutë e prera. Prej shtëpisë deri në male largësia është diku 1 km, shtëpia e tij është pak më naltë nga shtëpia e B. ashtu që mund të dëgjohet zhurma e motor sharës. Përndryshe mali ku ka ndodhur ngjarja i takon babait të tij dhe në kadastër është evidentuar në emër të babait i cili ka vdekur në vitin 1999 pasi që janë gjatë vëllezër e një motër kur janë ndarë në mesë veti ky mal i ka takuar babait, ndarja ka ndodhur në vitin 2004. Kush e ka goditur B. dhe F.1 nuk e din sepse ai dhe djem të tij nuk kanë pasur asgjë në duar ndoshta F. është goditur kur V. e ka tërheq dhe kanë filluar të rrokullisen ndërsa për B. nuk e di. Këtë mal deri ditën kritike askush prej familjes L nuk e ka shfrytëzuar sepse kanë lënë të ritet dhe kanë ruajtur. Me B. dhe F.1 më herët nuk kanë pasur mosmarrëveshje. Sa i përket raporteve në mesë tyre pas rastit shton se kanë pranuar të bisedojnë me njerëz që kanë ardhur si ndërmjetësues por nuk kanë pranuar të pajtohen. Në cilësinë e dëmtuarit parashtron kërkesën pasurore juridike ndaj B. dhe F.1.

I akuzuari F. L.2 në mbrojtjen e vetë ka deklaruar se 3 – 4 ditë para rastit kanë vërejtur se mali i cili gjendet në vendin e quajtur ..., e cila është pronë e babait është vjedhur ndërsa ditën kritike babai i tij H. ka dëgjuar një zhurmë të motor

sharës ashtu që së bashku kanë shkuar në mal dhe kanë vërejtur B. dhe F.1 aty, në fillim me telefon ka fotografuar duke iu thënë shihemi në gjykatë, në atë momente B. i cili ka pasur në dorë motor sharën e ndezur ka goditur V. në fytyrë ndërsa F.1 e ka goditur me sopat në pjesën e përparme të kokës dhe duke parë këtë situatë ka filluar që të largoj V. ashtu që është goditur prej F.1 me sopat në boshtin kurrizor ndërsa nuk e din kush e ka goditur babanë me sopat, nuk ka lënduar asnjërin mund të ndodh që janë lënduar nga tentimi jonë për të marr mjetet të cilat i kanë pasur në duar. Në shqyrtimin kryesor ka shtuar se në momentin kur kanë mbri ka vërejtur se B. dhe F.1 kanë qenë duke bartur drutë nga vendi ku kanë prerë deri në traktorë dhe pasi ka bërë fotografimin me telefon B. ka marr motor sharën dhe e ka ndezë , fillimisht F.1 me sopat ka goditur babanë e pastaj B. ka marr motor sharën, e ka ndezur dhe e ka goditur V.. Nuk e ka parë momentin e goditjes kur F.1 ka marr sopatën dhe kur e ka goditur babën por ka parë kur babai i është rrëzuar në tokë. Në momentin kur B. me motor sharë ka goditur V. ka tentuar që prej B. të merr motor sharën dhe të largoj prej vëllait atëherë F.1 e ka goditur me sopat në boshtin kurrizor, në pjesën e poshtëm mbi bel një herë. Deri në vendin e ngjarjes kanë shkuar me kombi “furgon” .

I akuzuari V. L. në mbrojtjen e vetë ka deklaruar se ditën kritike babai i tij H. ka dëgjuar zhurmën e motor sharës nga mali ashtu që së bashku edhe me vëllain F.2, me kombi kanë shkuar në mal dhe aty kanë parë B. dhe F.1 duke prerë dru. F.2 e ka nxjerr telefonin dhe ka fotografuar duke i thanë shihemi në gjykatë. B. ka filluar të shaj dhe ka ndezur motor sharën ashtu që babai i ka thënë ndaluni, ka kthyer kokën nga ne duke i thanën hajdeni të ecim në shtëpi. Kur babai ka kthyer shpinën F.1 ka goditur me sopat në shpinë nga cila goditje babai ka rra në tokë pa vetëdije. Më pas B. iu është drejtuar me motor sharë në dorë dhe e ka goditur në fytyrë në faqen e djathtë dhe në dorën e majtë mbi bërryl por pasi që ka pasur të veshur jakenën e trash të dimrit motor shara është ndalur dhe në atë momente është goditur prej F.1 me sopat duke tërhequr sëpatën të dytë kanë rra në tokë dhe pasi që babai është kthjell i ka thanë që të largohen. Në shqyrtimin kryesor ka shtuar se nga shtëpia deri në mal mund të dëgjohet zëri i motor sharës. As ai, as babai dhe vëllai nuk kanë pasur asgjë në duar dhe asnjërin nuk kanë lënduar. Deri ditën kritike nuk kanë pasur asgjë të keq, pas rastit, pas një kohe B. dhe F.1 kanë dërguar do sebeb për të rregulluar raportet mirëpo i kanë thanë që këtë punë ia lejnë gjykatës.

Gjatë shqyrtimit kryesor janë lexuar provat materiale:

-akt ekspertimi mjekoligjor në bazë të dokumenteve të çështjes, nr. referencës PZ-786/16 të datës 05.07.2016 nga zyra e shërbyese G., ekspertit dr. M.

G. për të dëmtuarit H. L., F. L.1, B. L., F. L.2 dhe V. L.. Nga akt ekspertimi vërtetohet se H. L. ka pësuar dëmtimet edhe atë: mavijosje në kokë dhe hundë, gërvishtje në regjionin e hundës dhe në atë ballor, të cilat janë shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fort mbretës (jo të prehtë ) të cilit bëjnë pjesë të dëmtimeve të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin. I dëmtuari F. L.1 ka pësuar dëmtimet e lehtë trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin të cilat paraqesin ndrydhje në kokë dhe në qafë, plagë shqyese e ndrydhëse në kokë dhe gërvishtje në regjionin e fytyrës. I dëmtuari B. L. ka pësuar dëmtimet e përkohshme edhe atë gërvishtje në regjionin e fytyrës, ndrydhje në regjionin e shpatullës së djathtë dhe në regjionin e shpinës, të cilat janë shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fort mbretës (jo të mprehtë) të cilat bëjnë pjesë në dëmtimet të lehta trupore me pasojat e përkohshme për shëndetin. I dëmtuari F. L.2 ka pësuar dëmtime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin edhe atë: ndrydhje në anën e majtë të shpinës të shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fort mbretës (jo të prehtë). I dëmtuari V. L. ka pësuar dëmtime të rënda trupore të cilat paraqesin plagë shqyese e ndrydhëse në anën e djathtë në kokë dhe në fytyrë të shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të prehtë .

-raporti mjekësor 1124 të datës 13.02.2016 e lëshuar nga Emergjencia e Spitalit Rajonal në Prizren në emër të F. L. ku konstatohet diagnoza: contusio regio humbolis I. sin. dhe raporti mjekësor 1124, të datës 13.02.2016 e lëshuar nga Emergjencia – spitali rajonal në Prizren në emër të V. L. me diagnoz: vltc rek. capitis et faciel lakt. deks.

-raporti mjekësor 1125 të datës 13.02.2016 e lëshuar nga Emergjencia – Spitali Rajonal në Prizren në emër të H. L. ku konstatohet diagnoza: hematoma reg. capities et nasi, excoratio regio nasi et reg. frontalis.

-raporti mjekësor 1128 të datës 13.02.2016, lëshuar nga Emergjencia – Spitali Rajonal në Prizren, në emër të F. L.1 ku konstatohet diagnoza: kontusio capitis et solli, VLC capitis regio parietalist et accipitalis, excoriatio regio nasi et facialist.

-raporti mjekësor 1129 të datës 13.02.2016, të lëshuar nga Emergjencia – Spitali Rajonal në Prizren, në emër të B. L. ku konstatohet diagnoza: excoratio reg. facialist, contusio reg. scapularis dex. et reg. lubalis .

-është lexuar lista e dëshmimeve dosja e forenzikës HS –TK 045/16 të datës 13.02.2016 nga e cila vërtetohet se janë mare një motor sharë SHTILL, ngjyrë e kuqe dhe një sopat në garazhdën e pajisjeve të punës .

-është lexuar certifikata – njësia katastrale mbi të drejtë pronësore të datës 25.06.2016 në emër të bashkëpronarëve L. H., P. G. dhe Q. M..

-është bërë shikimi në foto dokumentacion në të cilën shihen pamja e garazhës të pajisjeve të punës ku është gjetur një motor sharë dhe një sopat, pamja e sopatës dhe motor sharës dhe pamja e të akuzuarve dhe lëndimet të pësuar ditën kritike

Gjykata në bazë të provave të administruara ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se të akuzuarit B. dhe F.1 janë vëllezër, i akuzuari H. është djali i axhës së tyre ndërsa të akuzuarit F.1 dhe V. janë djemtë e të akuzuarit H.. Ditën kritike të akuzuarit B. dhe F.1 kah ora 10:30, me traktor kanë shkuar në vendin e quajtur ... për të prerë dru. Pas një kohe në këtë vende kanë arritur edhe të akuzuarit H. me djem të tij ku kanë hasur në të akuzuarit B. dhe F.1 duke prerë dru dhe duke i përgatitur për transport. Së pari i akuzuari F.2 nga një lagësie të caktuar ka fotografuar me telefon këta të akuzuarit duke i pyetur se çka janë duke bërë dhe a është ai vendi i babës së tyre. Pas kësaj që të tretë me nga një dru nëpër duar u nisën në drejtim të tyre dhe pas një fjalosjeje ka ardhur deri te përleshja në mesë tyre, me ç raste i akuzuari B. ka lënduar të akuzuarin V. me motor sharë ndërsa i akuzuari F.1, i cili deri në ato momente ishte duke krasitur degët e druve, e ka goditur me sakicë të akuzuarin V., pas kësaj e gjithë kjo ndodhi mori hovë dhe secili ka goditur njeri tjetrin deri në momentin kur i akuzuari H. u tha të gjithëve që të ndalen se do të vriten në mes vete për kurrgjë.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar në bazë të deklaratave të të akuzuarve, provave materiale edhe atë raportet mjekësore, akt ekspertimit mjeko ligjor, deklaratës së ekspertit mjeko ligjor , listën e dëshmimeve dhe foto dokumentacionit.

Gjykata ka pranuar mbrojtjen e të akuzuarve se nuk është kontestuese që në mesë vete janë kushërinjtë, se ditën kritike të akuzuarit B. dhe F.1 kanë shkuar në mal, në vendin... , në pronën për të cilën secila palë pretendon se kanë të drejtën e pronësisë, se pas pak kohe në atë vende kanë shkuar i akuzuari H. me djemtë ku kanë hasur të akuzuarit të cilit ishin duke dru, se i akuzuari F.2 me telefon ka fotografuar tërë këtë situatë pas të cilës ka ardhur deri te shkëmbi i fjalëve dhe pastaj konfliktit fizik në mesë tyre.

Mirëpo gjykata nuk ka pranuar mbrojtjen e të akuzuarit H. se në vendin ... në mal ka shkuar pasi që ka dëgjuar zhurmën e motor sharës kjo sepse duke pasur parasysh distancën në mesë shtëpisë së tyre dhe vendit kritik, përveç kësaj edhe faktin se si ka mund ai të dinte se ajo zhurmë e motor sharës mu nga ai vende, meqenëse rreth fshatit ndodhen shumë vende me pyje. Poashtu gjykata nuk ka pranuar edhe pjesën e mbrojtjes se në momentin kritik as ai e as djem të tij nuk kanë pasur asgjë në duar, se nuk kanë lënduar askënd dhe se nuk e dinë në çfarë mënyrë janë lënduar të akuzuarit B. dhe F.1. Kjo sepse deklarata e tij është në kundërshtim me deklaratat e të akuzuarve B. dhe F.1 të cilit kanë deklaruar se janë goditur nga i akuzuari H. dhe V.. Përveç kësaj deklarata e tij është në kundërshtim edhe me provat materiale akt ekspertimi nga i cili vërtetohet se të akuzuarit B. dhe F.1 kanë pësuar lëndime të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbrethës.

Poashtu gjykata nuk ka pranuar mbrojtjen e të akuzuarit B. L. se i akuzuari V. është lënduar në momentin kur janë kacafytur mbi motor sharën e cila në ato momente ka qenë në tokë duke punuar dhe të akuzuarit F. se të akuzuarit H. e ka goditur me dru e jo me sakicë. Kjo sepse mbrojtja e tyre është në kundërshtim me deklaratën e ekspertit mjeko ligjor i cili në shqyrtimin kryesor në mesë tjerash ka deklaruar se mendimin e dhënë në akte ekspertimin plotëson se i akuzuari – dëmtuari V. L. ditën kritike ka marr 4 plagë: një plagë prerëse me gjatës 15 cm në anën e djathtë të sipërme të kokës, disa plagë prerëse në anën e djathtë të fytyrës të cilat janë paralele me gjatësi rreth 3 cm secila, një plagë shqyese ndrydhëse në pjesën e jashtme të regjionit të bryllit të dorës së majtë me dimensione rreth 10 x 2 cm dhe plagë në pjesën e jashtme të pjesës së poshtëm të parakrahut të dorës së majtë . Me besueshmëri plagët e përshkruara në pikën 1,2 dhe 4 janë të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të prehtë ndërsa palaga në pik. 3 është shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit mbretës (jo të prehtë) . Shton se i dëmtuari ka pas gjakderdhje të madhe për shkak të katër plagëve të marra , është dashur të ndërhyje në mënyrë operative për qepur plagët dhe ndalur gjakderdhja ashtu që si të tilla këto dëmtime kanë qenë të rrezikshme për jetën në momentin e dëmtimit dhe bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore. Në bazë të ekzaminimit të dëmtuarit, tani pas 2 vite konstaton se dëmtimet janë pa pasoja funksional me përjashtim të cikatriksave (vrajeve) të mbetura në vendin ku i ka pasur plagët ashtu që plaga në kokë është e njëtrajtshme dhe mjete i prehtë që e ka shkaktuar këtë plagë ka pasur një formë vijezore ndërsa plaga në fytyrë dhe në pjesën e poshtëm të majtë kanë formë paralele të njëtrajtshme dhe në bazë të kësaj konstaton se mjete nuk ka pas një formë fijejorë por ka pasur një formë me disa teh paralele të katër plagë veç e veç

nëse do të kishin të bënin vetëm me njërin nga ato janë të natyrës së letë trupore mirëpo si tërësi dhe së bashku janë të rënda.

Nga arsyet e cekura gjykata konstaton se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjithë elemente e veprave penale për të cilat janë shpallur fajtor dhe dënuar sipas ligjit.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KP, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat si ato rënduese po ashtu edhe ato lehtësuese, prej rrethanave rënduese morri parasysh shkallën e përgjegjësisë penale e të akuzuarve, për të akuzuarit B. dhe F. L.1 mjetet të cilat janë përdorur në rastin konkret, ndërsa prej rrethanave lehtësuese ka marrë parasysh se në mesë vete janë kushërinjtë se të akuzuarit B. dhe F. L.1 kanë treguar vullnetin për rregullimin e raporteve duke dërguar njerëz për pajtim e poashtu duke kërkuar falje publike gjatë seancës, se janë relativisht të rinj, rrethanat familjare, se janë të martuar dhe kanë fëmijë të mitur ndërsa për të akuzuarit H., F.2 dhe V. L. se në mënyrë indirekte kanë treguar gatishmëri për rregullimin e raporteve, për të akuzuarit F.2 dhe V. L. se janë të rinj, si dhe për të gjithë të akuzuarit sjellja korrekte gjatë procedurës, andaj gjykata ua shqiptoi dënimet si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke konsideruar se edhe me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi dënimin plotësues është marr në bazë të nenit 69 të KP-së.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marr në bazë të nenit 463 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 KPP.

Nga se u tha më lart u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.80/17 me datë 18.06.2018**

**sekretarja juridike,**  
**Valdete Zurnaxhiu**

**Përkthyesja gjyqësor**  
**Asnije Berisha**

**Kryetarja e trupit gjykues,**  
**Raima Elezi**



**UDHËZIM JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.